



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës (në tekstin e mëtejme OMK), përmes Komisionit për edukimin e vazhdueshëm profesional të Odës së Mjekëve të Kosovës, duke u bazuar në dispozitat e Rregullores së këtij Komisioni dhe propozimet e Komisionit Ad-hoc të datës 22 maj 2023 për vlerësimin e nevojave të paraqitura të profileve në Institucionet shëndetësore, në lidhje me subvencionimin e profilizimeve të veçanta të specialistëve me datë 31 maj shpall:

KONKURS PUBLIK PËR PËRKRAHJEN E VEÇANTË FINANCIARE TË PROFILIZIMEVE

Hyrje

Oda e Mjekëve të Kosovës, përmes organeve të saj, respektivisht Komisionit për edukim të vazhdueshëm profesional, me qëllim të përkrahjes së zgjerimit dhe avansimit të edukimit të vazhdueshëm profesional, do të përkrahë financiarisht profilizimeve të veçanta të specialistëve që janë anëtar të OMK-së.

Kjo përkrahje financiare do të realizohet sipas thirrjes për shprehje të interesit e cila i'u është drejtuar Institucioneve shëndetësore me datë 16 mars 2023 përmes të cilit është kërkuar nga këto Institucione që të shprehin interesin duke listuar profilet e nevojshme brenda lëmive specialistike lidhur me personelin e tyre. Pas dorëzimit të profilizimeve e specialistëve nga ana e Institucioneve shëndetësore, Këshilli Drejtues i OMK ka themeluar Komision Ad-hoc i cili pas shqyrtimit të nevojave të paraqitura i ka propozuar Këshillit Drejtues aprovimin e listës së profileve dhe hapjen e konkursit publik.

Me rastin e aprovimit të propozimeve nga Këshilli Drejtues i OMK, fillon edhe procedura e rekrutimit për ndarje të profilizimeve, procedura për të cilat Komisioni për EVP do të autorizohet për shqyrtimin e tyre.

Me qëllim të aplikimit të mbështetjes financiare sipas për profilizimet e veçanta, Oda do të mbuloj 40% të shumës, por jo më shumë se 5.000,00€.

Lista e profileve të paraqitura dhe të aprovuara:

Nr.	Institucioni shëndetësor	Lloji i profilizimit	Numri i vendeve
1	Institutet Paraklinike	- Nefropatologjia/Uropatologjia - Hematologjia	2 2
2	Klinika e Pediatriisë	- Endokrinologji Pediatrike - Gjenetika Klinike - Neurologji Pediatrike - Gastrohepatologji	2 2 2 2
3	Klinika e Radiologjisë	- Raiologji intervente (Endovaskulare) - Radiologji Pediatrike	2 2
4	Klinika e Neonatologjisë	- Neorologjia perinatale dhe neonatoale	2
5	Spitali i Përgjithshëm Prizren	- Laparaskopia kirurgjike, gjinekologjike, urologjike - MRI (Radiologjia) - Neurologji EEG (Pediatrike)	2 2 2 2 2

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për të drejtën e konkurimit

Kushtet e përgjithshme si në vijim:

- Dëshminë e aplikuesit se ka statusin aktiv të anëtarit të OMK-së;
- Dokumentet përcjellëse të kredencialeve profesionale siç është certifikata e specializimit dhe licenca specialistike valide. Në rast se aplikuesi e ka përfunduar shkollimin specialistik jashtë Republikës së Kosovës, do të aplikohen përshtatshmërisht dispozitat lidhur me nostrifikimin dhe barazvlerësimin e shkollimit në shtetet e huaja; dhe
- Dëshmia se aplikuesi nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore dhe ndaj tij nuk është shqiptuar ndonjë sanksion penal lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale që ndërlidhet me ushtrimin e profesionit të mjekut.

Kushtet e veçanta si në vijim:

- Elaborati profesional/shkencor me të cilin do të përshkruhet përmbajtja e profilizimit të përzgjedhur nga aplikuesi (përfshirë profilizimin të cilin e propozon në mënyrë vetanake aplikuesi); dhe
- Pëlqimi dhe arsyetimi i nevojës profesionale ana e Drejtorit të Klinikës/Drejtorit të SR, në të cilin e ushtron veprimtarinë mjekësore aplikuesi.
- Aplikantët duhet të jenë të punësuar me orar të plotë në njërin nga njësitë përbërëse të ShSKUK-së;
- Aplikuesi me rastin e aplikimit duhet të deponoj deklaratë me shkrim përmes së cilës zotohet se do të vazhdoj angazhimin me orar të plotë pranë institucionin gjegjës së paku edhe për tre vite pas përfundimit të profilizimit;
- Në rast se aplikuesi nuk i përmbahet deklaratës nga pika paraprake, i njejti obligohet të bëjë kthimin e mjeteve financiare të ndara për edukimin e vazhdueshëm profesional në afat prej 14 ditësh nga shkëputja e kontratës;
- Përkrahja financiare do të ndahet vetëm për profesionistët shëndetësor me rol aktiv në edukim/përfitimimi i njohurive nga aspektit praktik;
- Profilizimi duhet të jetë nga lëmia specifike specialistike që i përgjigjet fushës së specializimit të aplikuesit;
- Njohuritë e fituara nga profilizimi duhet të jenë të aplikueshme në punën që e ushtron pjesëmarrësi;
- Aplikuesi duhet të jetë i aftë të flas dhe të kuptoj gjuhën e profilizimit.

Informacione të tjera:

- Konkursi publik do të jetë i hapur në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e publikimit të tij;
- Dokumentacioni sipas kriterëve të lartëcekura duhet të dorëzohet në ekzemplar fizik dhe në dokumente origjinale apo të noterizuara.
- Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në zyret e OMK, me adresë: QKUK, INSTITUTI A, KATI I III-TË, 10 000 – PRISHTINË RKS. Personi kontaktues: Liridon Beha/Mergime Krasniqi, nr. kontaktues 049/872-070.
- Afati i fundit për aplikim: 30 qershor, ora 16:00.